

SHYQYRI HYSI**ROMËT DHE INTEGRIMI I TYRE NË SHOQËRINË
SHQIPTARE, RASTI I GJIROKASTRËS***

Në territorin e Republikës së Shqipërisë punojnë e jetojnë edhe disa popullsi jo shqiptare, të cilat njihen si minoritete. Midis tyre bën pjesë edhe komuniteti rom.¹ Ky komunitet njihet zyrtarisht në Shqipëri, si një pakicë² linguistike dhe kulturore³. Ky përcaktim konfirmohet edhe në raportin zyrtar që qeveria e Tiranës përpiloi në prill të vitit 2001, mbështetur në nenin 25 të “Konventës kuadër të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare”, raport në të cilin, kjo popullsi së bashku me arumunët cilësohej si pakicë linguistike. Në këtë raport thuhej; “*Romët dhe arumunët janë njohur dhe respektuar si pakica linguistike*”. Më tej, të drejtat e këtij komuniteti mbrohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,⁴ nga ligjet që burojnë prej saj, si ligji nr. 69, datë 21.06.2012 “*Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, neni 5 “*E drejta për arsim*” pikat 1, 2, neni 10 “*Arsimimi për pakicat kombëtare*” pikat 1, 2 dhe 3, neni 12 “*Arsimimi në dy gjuhë.*” Ligji është miratuar prej Parlamentit Shqiptar, datë 21. 06. 2012 dhe është dekretuar prej presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Bamir Topi, me dekret nr. 7696 datë 18. 07. 2012. Ky ligj dhe ligjet e tjera që veprojnë në Republikën e Shqipërisë janë hartuar duke u mbështetur tek

* Një pjesë e materialit është përdorur në kumtesën e mbajtur në Konferencën Shkencore me temë: “*Shteti, Shoqëria e Drejta: Bashkëpunimi Rajonal*”, organizuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe nga “Albanian University”, data 23 dhe 24 maj 2014. Materiali është ripërpunuar.

¹ Arqile Bërzholi, *Minoritetet në Shqipëri (studim demografik)*, Tiranë: 2005, f. 122-123.

² Metais Serge, *Historia e shqiptarëve dhe ilirëve deri tek pavarësia e Kosovës*, Tiranë: 55, 2006, fl. 359.

³ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, Tiranë: Kristalina KH, 2013, f. 121-123.

⁴ *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, USAID, Tiranë: 1998, neni, 15, fl. 7; neni 18, fl. 8; neni 21, fl. 9.

“Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian”,⁵ në Kartën e Parisit⁶ etj.

Opinionimi publik, shkencor dhe politik shqiptar pas viteve 90-të rimori në shqyrtim problemin e minoriteteve, përfshi edhe pakicën kulturore rome. Ridimensionimi i tyre erdhi si rezultat i një sërë faktorëve:

- Shqipëria hyri në rrugën e demokracisë dhe u realizua hapja e saj me botën perëndimore.

- U vendos pluralizmi politik dhe lindën parti e shoqata, të cilat me programet e tyre u angazhuan në faktorizimin dhe mbrojtjen e pakicave.

- Shqipëria u bë anëtare e disa organizmave dhe organizatave ndërkombëtare, me të cilat nënshkroi konventa e marrëveshje, të cilat u kushtojnë vëmendje të posaçme minoriteteve.

- U nënshkrua Karta e Helsinkit dhe startoi integrimi euroatlantik i Shqipërisë, procese që kushtëzojnë trajtimin e pakicave kombëtare.

Në rajonin e Ballkanit, përfshi edhe Shqipërinë gjendet një popullsi nomade tepër sinjifikative, e cila në gjuhën shqipe⁷ njihet me disa emra si; “arixhinjë”, “harixhinjë”, “gjyp”, “magjypë”, “rom”, “cigan”,⁸ “gabel”. Në gjuhën angleze dhe në botimet anglisht njihen me emrin gypsy - gypses,⁹ emër që evidentohet qysh prej vitit 1537. Gjermanët¹⁰ e njohin këtë popullsi me emrin rom, me të cilin nënkuptojnë një njeri ose një grup njerëzish muzikantë; me emrin zigeuner-njeri i parregullt dhe gypsish-njeri që rri vazhdimisht përjashta. Për herë të parë në botimet shkencore gjermane ky emër (zigeuner) evidentohet në vitin 1841. E njëjta dukuri vihet re edhe tek francezët, të cilët sikurse shqiptarët dhe gjermanët përdorin emra të ndryshëm për të identifikuar popullsinë rome.

⁵ Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian (2000/C 364/01), datë 18 dhjetor 2000, Numri CELEX 32000X1218(01) Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria C, Nr 364, datë 18.12.2000, fl. 1-22.

⁶ KSBE, *Karta e Parisit për një Evropë të re*, Tiranë: 8 Nëntori, 1991, f. 6-10.

⁷ *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 169. “Pjesëtar i një popullsie me prejardhje nga India dhe që jetojnë zakonisht në mënyrë endacake a gjysëmendacake në Evropë e në disa vende të Azisë e të Afrikës; rom; arixhi’.

⁸ A, Dhurma, R. Memushaj, *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Tiranë: INBOTUES, 2011, f. 115.

⁹ *Fjalor anglisht. Oxford Wordpower*, “Oxford University Press”, Oxford: 2000, f. 305.

¹⁰ Fjalori gjermanisht-shqip, *DUTSCH-ALBANIAN WORTERBUCH*, Tiranë: Fllad, 2001, f. 434.

Ata përdorin *tsigan*,¹¹ *bohem dhe bohemine, ienne*¹². Rumunët i thërrasin *lungurari - lugë punues*; italianët *zingari*,¹³ ndërsa grekët¹⁴ *giftos - njeri me prejardhje prej Egjiptit*. Rusët¹⁵ dhe sllavët përdorin emërtimin *ciganin*¹⁶, ndërsa turqit *kopt*, që konsiderohet etimologji arabe dhe përdoret qysh prej regjistrimit të popullsisë në Perandorinë Osmane në vitin 1520. Arumunët i thërrasin romët *mandu (harixhi, romë) – mandri (harixhijnë, romë)*.¹⁷

Romët e quajnë veten rom, që në gjuhën e tyre do të thotë *njeri, popull*. Me këtë emërtim ata njihen sot në të gjitha dokumentet e organizmave ndërkombëtarë. Në Shqipëri për herë të parë emri rom evidentohet në vitin 1635.¹⁸ Për romët kanë shkruar disa autorë midis tyre përmendim: Jules Bloch, Jan Koconovski, Desarata Sharmas etj. Vendi, nga ata janë shpërngulur, pranohet të jetë Harixhistani (krahina e Harixhas, shteti i Katjavarit¹⁹) ose pjesa veriperëndimore e Indisë. Lëvizja e tyre fillimisht evidentohet drejt Persisë dhe pastaj ndahen në tre tribu të mëdha, të cilat lëvizën drejt veriut dhe perëndimit rreth shek. X. Nëpërmjet Industanit, kjo popullsi hyri në Evropën Lindore në shek. XI, dy shekuj më pas u përhap më në jug²⁰ dhe në Ballkan.²¹ Por, për kohën e shpërnguljes ka edhe mendime se, romët mund të jenë shpërngulur gjatë shek. XII, pas betejës së Taraimës 1192.²² Megjithatë romanologu Jules Bloch (1880 – 1953) në punimin: “*Les tisiganes*” u shpreh se, ende nuk “*jam i bindur për vendin e shpërnguljes*”.

Përsa i përket gjuhës rome, studiuesit janë të mendimit se, ajo bën pjesë në familjen e gjuhëve indo- iraniane dhe është e afërt me gjuhën e

¹¹ *Fjalor frëngjisht-shqip*, Tiranë: 8 Nëntori, 1989, f. 1111.

¹² *Po aty*, f. 126.

¹³ Giacomo Devoto, Gian Carlo Oli, *Dizionario Devoto Oli della Lingua italiana*, “*Le Monnier*”, Firenze: edizione 2004-2005, f. 3109.

¹⁴ Jorgo Babinjati, *Fjalori enciklopedik*, Athinë: EPE, 2008, f. 223.

¹⁵ S. J. Ozegov, *Fjalori i gjuhës ruse*, Tiranë: Gjuha Ruse, 1989, f. 875.

¹⁶ M. Mançe, Xh. Zyka, L. Dhimitri, L. Myrtaj, N. Malo, *Fjalor rusisht-shqip*, Tiranë: EDFA, 2005, f. 1009.

¹⁷ Papahagi, Tache, *Deitionarul dialectului aromin, Shtëpia botuese e Akademisë*, Tiranë: 1963, f. 654.

¹⁸ A. Bërxfholi, *Minoritetet në Shqipëri ...*, f. 123.

¹⁹ Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare shek. XV – XX*, Tiranë: Mihal Duri, 1973, f. 52.

²⁰ *Po aty*, f. 122.

²¹ Muhamet Tërnova, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë: 1995, f. 254-268.

²² *Vjesnikov IZOBOR*, nr. 6, Zagreb: 1965, f. 127-130, përkthyer prej Shefik Sh. Voca.

Indisë Veriperëndimore. Studiuesit i gjejnë rrënjët e kësaj gjuhe në gjuhën e Penxhabit të lashtë. Gjuha e tyre flitet sot me huazimet e marra prej popujve, me të cilët kanë bashkëjetuar ose kanë pasur kontakte romët gjatë rrjedhave të historisë. Studiuesit dallojnë tre grupe gjuhësore rome: **Domari**, poseduesit e saj jeton në Evropën Lindore dhe Lindjen e Mesme; **Lomaruren**, konsiderohet grupi i banorëve që jeton në Evropën Qendrore dhe grupi **Romani**, i cili jeton në Evropën Perëndimore. Të gjitha grupet rome kanë nga 4 nëngrupe dhe 10 tribu. Ata janë të ndara në konfederata dhe secila prej tyre ka nga 10 - 100 mijë familje. Midis grupeve përmenden: Kalderashët, Makavajt. Lovari, Kurari, Romanikal, Gjitanoes, Kalo, Sinti, Rudari, Manush, Bojash, Ungarica, Luri, Bashalde, Romungo, Zoraksi etj.

Një tregues sinjifikativ i shkallës së zhvillimit, kontakteve dhe kulturës së tyre është edhe besimi fetar. Kjo popullsi i përket besimit mysliman²³ dhe të krishter. Sipas regjistrave të kohës osmane,²⁴ në gjithë vilajetet e saj dominonin ciganët e besimit islam.²⁵ Gjatë regjistrimit të popullsisë në Elajetin e Rumelisë në vitin 1520 u regjistruan 17 000 romë, prej të cilëve 60% të krishterë dhe 40% myslimanë²⁶ ose 10 200 romë të krishterë dhe 6 800 romë myslimanë. Besimi i romëve sot është përshtatur me besimin fetar të atyre vendeve ku janë rezident. Pothuajse shumica e tyre janë konvertuar në katolikë dhe në ortodoksë. Por, megjithëse të konvertuar, ata festojnë disa festa pagane dhe myslimane, siç është takimi i tyre në qytetin bregdetar francez, Shën Mëria e Detit (*Saintes – Maries – de – la – Mer*). Aty çdo vit në muajin maj mbledhen romët nga të gjitha vendet e botës pa dallim përkatësie fetare. Një element tjetër i trashëgimisë së kulturës etnike rome, që kultivohet edhe sot, është adhurimi i hyznisë dhe totemisë së tyre historike, Kalit.

Interesant është fakti se ligjet osmane²⁷ nuk i përjashtuan nga taksat romët, as myslimanët që paguanin 22 akçe, as të krishterët që paguanin 32 akçe taksa.²⁸ Por, osmanët veç diferencimit në vlerë fiskale, nxorën

²³ Rizaj Skënder, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVI: administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore*, Prishtinë: 1982, f. 68.

²⁴ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë-Tiranë: Koha, 2001, f. 214.

²⁵ Justin McCarthy, *Vdekje dhe dëbi, spastrimi etnik i myslimanëve osman, 1821-1922*, Tiranë: ALSAR, 2015, f. 397.

²⁶ N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër ...*, f. 14.

²⁷ *Po aty*, f.15.

²⁸ S. Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV ...*, f. 418.

edhe ligje, me anë të së cilëve ndalonin martesat midis romëve myslimanë dhe të krishterë. Kjo masë juridike që nuk u aplikua për popullsitë e tjera, konsiderohet si një faktor i rëndësishëm në konvertimin e romëve.

Romët kryejnë disa profesione të cilat janë në traditën e tyre. Ata janë muzikantë, farkëtarë, fallxhorë, mjekë popullorë, tregtarë, stërvitës arinjsh, furrtarë, lëkurëpunues etj. Por romët kanë shërbyer edhe si trupa mbrojtëse ushtarake. Gjatë sundimit osman në Ballkan, romët përmenden në disa raste përkrah osmanëve, fillimisht si trupa të prapavijës. Në vitin 1566 evidentohet një dekret, i cili shpall rekrutimin e romëve në radhët e trupave ushtarakë osmanë.²⁹ Po gjatë kësaj kohe turqit i titullojnë romët “*gyryk*”, që ishte emri i një fisi baritor turk, i cili kishte tipare shumë luftarake. Në vitin 1737, romëve iu besua mbrojtja e Serbisë Jugore, ndërsa në vitin 1788, romët e Bosnjës penguan invadimin ushtarak të Austro-Hungarisë.

Përgjatë historisë vihet re një persekutim permanent për romët. Represioni i parë ndaj tyre evidentohet në vitin 1539 në Paris. Në vitin 1563 Anglia i kërcënoi zyrtarisht me vdekje në se nuk largoheshin prej saj. Edhe në Spanjë, gjatë viteve 1499-1783 dolën disa ligje të cilat synonin t’u ndryshonin romëve, doket, zakonet, traditën, gjuhën, veshjet etj. Gjatë shek. XVII Rumania dhe pas saj Hungaria, me ligjet e tyre krijuan një situatë kritike për romët. Studiuesit e Luftës së Dytë Botërore konfirmojnë se krahas çifutëve,³⁰ nëpërmjet holokaustit u eliminuan në dhomat e gazit rreth 500 mijë deri në 1.5 milion romë. Masakra më e madhe konsiderohet ajo e natës midis 2 dhe 3 gushtit 1944 në Auschwitz – Birkenaut në jug të Polonisë. Sot për nder të tyre është ngritur një memorial në Auzhvic, i cili quhet *Porajmos*. Një përmendore në kujtim të viktimave naziste me origjinë sinte dhe rome u ngrit, më 24.10.2012 në Berlin, vepër e skulptorit izraelit Dani Karavan.³¹ Është fakt se në ditët tona emri “*gabel*” dhe “*evgjil*”, të cilët përfaqëson popullsinë me ngjyrë (rome), përgjithësisht ka karakter përçmues. Me këtë emër janë identifikuar disa njerëz pjesëtarë të një komuniteti shoqëror tepër të varfër, pa përkrahje, pothuajse të braktisur prej shoqërisë dhe shteteve përkatëse.

²⁹ N. Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër ...*, f. 215.

³⁰ Roberto Batalia, *Lufta e dytë Botërore*, Tiranë: 8 Nëntori, 1991, f. 211-213.

³¹ Deutsche Welle, Made for minds, datë 24.10.2012, f. 1.

Sipas statistikave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të vitit 2010 sot në botë jetojnë rreth 6-7 milionë romë. Sipas regjistrimeve të OKB gjatë viteve 1990-1992, numri më i madh i tyre jetonte në Evropë. Në Rumani jetonin 409 723 persona, në Hungari 190 046, në Bullgari 314 019, në Greqi 139 300, në Serbi dhe Mal të Zi u regjistruan 138 000, në Itali 100 000, në Sllovaki 90 000, në Maqedoni 56 000 dhe në Ukrainë 48 000 romë.³²

Sa i përket Shqipërisë³³ numri i popullsisë rome ka pësuar oshilacione. Të dhënat e para i gjejmë në statistikat osmane dhe shteteve fqinje. Autori George Kastelan në punimin: “*Historia e Ballkanit shek. XIV–XV*”, jep disa statistika për romët në vilajetet shqiptare pa vilajetin e Kosovës, shifra, të cilat Castelan nuk i beson edhe vetë, ai thekson: “*Vështirë të meren seriozisht këto të dhëna*” dhe më tej pasqyron tabelën, prej së cilës po pasqyrojmë vetëm pjesën e popullsisë rome.³⁴

Nr.	Popullsia	Shteti që i jep statistikat	Numri i popullsisë	Viti
1	romë/cigan	Serbia	8700	1880
2	romë/cigan	Greqia	89002	1904
3	romë/cigan	Bullgaria	54500	1895

Në regjistrimin e vitit 1920 numri i popullsisë rome kapte shifrën e 20 000 frymëve, ndërsa në regjistrimin e vitit 1938 numëroheshin rreth 30 000 të tillë.³⁵ Pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri nuk u tregua kujdes për regjistrimin e plotë të tyre. Në këtë kontekst në regjistrimin e vitit 1955, rezulton se, në Shqipëri kishte 930 *gabelë*(romë), nga të cilët 264 meshkuj, 266 femra dhe të tjerët fëmijë.³⁶ Në vitin 1995, sipas **Grupit Ndërkombëtar të të Drejtave për Minoritetet**, numri i romëve në Shqipëri ishte rreth 100 000 mijë frymëve. Ndërsa sipas një studimi të përgatitur nga Universiteti i Merilendit numri i tyre arrinte në rreth 120 000. Në vlerësimin e UNICEF-it rezulton se: “*Në Shqipëri ka 15 000*

³² A. Bërxfholi, *Minoritetet në Shqipëri ...*, f. 126.

³³ Faik Konica, *Shqipëria kopshti shkëmbor i Evropës juglindore dhe ese të tjera*, Tiranë: Gjon Buzuku, 1993, f. 78. “*Elementët e huaj më interesant në Shqipëri janë ciganët. Si në çdo vend, edhe këtu ndahen në dy kategori: ciganët shëtitës dhe cygnet joshëtitës*”.

³⁴ Castelan George, *Histori e Ballkanit shek. XIV – XV*, Tiranë: Çabej, 1996, f. 374-375.

³⁵ A. Bërxfholi, *Minoritetet në Shqipëri ...*, f. 126-129.

³⁶ *Po aty*, f. 128.

romë të vendosur në 108 vendbanime dhe të shpërndarë në zonat urbane dhe rurale të vendit.³⁷

Sipas studiuesit Arqile Bërxfoli dislokimi i romëve në Shqipëri është kryesisht në periferi të qyteteve si në: Durrës, Fier, Berat, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Krujë, Fushë – Krujë, Shkodër, Lushnje, Tiranë, Vlorë, Pogradec, Bilisht, Delvinë, Sarandë, Përmet. Në fshatrat Moravë, Levan, Çlirim, Llakatund, Klos, NB – Pukë etj.³⁸ Disa prej fiseve më të njohura rome në Shqipëri janë Meçkarët, Karbuxhinjt, Cigarët, Kurtofët, Abuxhinjtë etj.

Situata tepër e vështirë e romëve e nxiti qeverinë shqiptare të hartojë në vitin 2003 strategjinë **“Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom”**³⁹. Një sërë ligjesh, vendimesh⁴⁰ dhe udhëzimetu miratuar për këtë komunitet midis të cilëve përmendim ato të fushës së arsimit: *“Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbërit, invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jo universitare profesionale, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë”*⁴¹ Avokati i Popullit, Igli Totozani e ka konsideruar legjislacionin ende të pamjaftueshëm për të siguruar trajtimin e duhur për romët.⁴² Pas tragjedisë, në familjen Ramazani në Gjirokastrë, avokati e vuri theksin në pamundësinë e bashkive për t’i ndihmuar romët. Ai kërkoi sërish ndryshime në legjislacion. Më datë 3 nëntor 2013, bashkia e Gjirokastrës miratoi një plan lokal veprimi për integrimin e romëve në territorin e administruar prej saj për vitet 2013-2015 një gëntplan për rregullimin e territorit ku banonte komuniteti rom.⁴³ Ky plan veprimi mbështetet në: *“Parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit; integritit social; qytetarisë*

³⁷ Redaksia e gazetës, “Romët në Shqipëri një komunitet i lënë në harresë të plotë”, në *Shqiptarja. com*, datë 10.08.2013, marrë nga Deutche Welle.

³⁸ A. Bërxfoli, *Minoritetet në Shqipëri ...*, f. 122.

³⁹ Vendim nr. 9, datë 6.1.2011 Për miratimin e raportit të tretë të konventës kuadër të Këshillit të Europës *“Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”*. *Fletore Zyrtare*, nr.5 datë. 27. 01. 2011, f.69.

⁴⁰ *Fletore Zyrtare*, nr. 132, datë 13. 08. 2008, f. 5873.

⁴¹ *Fletore zyrtare*, nr. 176, datë 09. 10. 2015, f. 1222.

⁴² Igli Totozani, “Duhet të ndryshojë legjislacioni që të mos ndodhin tragjedi të tilla”, *Telegraf*, datë 22.04.2014, f. 2.

⁴³ *Arkivi i Bashkisë së Gjirokastrës*, Viti 2013, Dosja 2, fl. 2.

dhe pjesëmarrjes; parimit të decentralizimit etj”.⁴⁴ Bashkia Gjirokastër ka miratuar edhe ndihma ekonomike për këtë kategori sociale. Në bazë të të dhënave që disponon Zyra Ekonomike e Bashkisë Gjirokastër rezulton se, janë 48 kryefamiljarë ose gjithsej 227 persona, të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike.⁴⁵ Sipas statistikave të Bashkisë Gjirokastër, në territorin e administruar prej saj në vitin 2013 jetojnë 501 persona që përfaqësojnë komunitetin rom, të vendosura në dy qendra: pranë urës së lumit Drino, në krahun e djathtë të tij dhe në periferinë jugore të qytetit, pranë Teqesë së Zallit dhe Lagjes Zinxhiraj mbi zonën industriale të qytetit.

Në Shqipëri romët merren kryesisht me tregti dhe artizanat. Sipas një studimi të Fondacionit Soros rezulton se 50% e këtij komuniteti është i papunë. Komuniteti është kryesisht i vetpunësuar në mbledhjen e hekurishteve, kanoçeve, shitjen e rrobave të përdorura, etj. Përsa i përket tregtisë së këtij komuniteti në Gjirokastër, ajo ka pasur karakter spontan dhe individual. Por, që nga marsi i vitit 2014 të gjithë tregtarët ambulante të këtij komuniteti kanë ndërtuar tregun e tyre. Ky treg ka vuajtur pasojën e mos legalizimit të ambienteve përkatëse. Fillimisht tregu u vendos tek ura e lumit, pastaj për rreth një viti funksionoi normalisht në lagjen “18 shtatori”, pranë tregut të fruta perimeve. Por, pas zgjedhjeve të vitit 2015 Bashkia e qytetit mori vendimin, që ky treg të zhvendosej në rrugën që lidh lagjen Granicë me atë të Grehotit. Komuniteti rom disa herë nëpërmjet mjeteve televizive e ka kontestuar këtë hapësirë, thjesht për pozicionin periferik në tij, por, duhet theksuar se hapësira për zhvillimin e tregtisë në këto ambiente është e bollshme.

Për këtë komunitet ka një kujdes në rritje edhe në fushën e arsimit, jo vetëm nga pushteti qendror por edhe nga pushteti vendor dhe DARGJ (*Drejtoria e Arsimit Rajonal të Gjirokastrës*). Drejtoria Arsimore e Gjirokastrës ka implementuar disa projekte në bashkëpunim me disa organizata jofitimprurëse si: “Save the Children”, “CRCA – Observator”, “Amarodrom” etj. Gjithë veprimtaria dhe kujdesi ndaj fëmijëve romë, mbështetet në udhëzimin nr. 25, datë 17.08.2015 “*Për sistemimin arsimor parauniversitar ne Republikën e Shqipërisë*”.⁴⁶

⁴⁴ *Po aty*, fl. 9-10.

⁴⁵ Material i Zyrës Ekonomike, Bashkia e Gjirokastrës, nr. 21, dhjetor 2014.

⁴⁶ Udhëzimi nr. 25. MAS drejtuar DAR/ZA, nr. Prot. 6013, datë 17. 08. 2015. *Fletore Zyrtare*, nr. 176, datë 09. 10. 2015, fl. 1207.

Disa prej programeve dhe planeve me karakter kombëtar dhe lokal, që janë në zbatim e sipër për të ndihmuar dhe trajtuar specifikiisht fëmijët romë janë:

- Në kuadër të “*Dekadës Rome*” është hartuar Strategjia Kombëtare për romët.
- Projekti i përfunduar për kopshtin nr. 5, ngritur në lagjen “*Zinxhiraj*” të Gjirokastrës.
- Projekti me shkollën “*Çajupi*”, titulluar “*Punojmë së bashku*”.
- Po në këtë kuadër është ngritur edhe shkolla “*Së bashku*,” e cila ka gjithësej 63 nxënës të ciklit fillor.
- Është duke u zbatuar plani për “*Digjitalizimin e informacionit për romët në nivel institucional*”.
- Projekti për mbështetje me bursa për fëmijët romë.
- Projekti kombëtar për dhënie të teksteve falas për fëmijët romë.
- Projekti “*Çdo fëmijë rom në kopsht*”.

*Gjendja numerike e nxënësve romë në shkollat e qytetit të Gjirokastrës për vitin akademik 2015 - 2016 është si vijon:*⁴⁷

Nr.	Klasa I	Klasa II	Klasa III	Klasa IV	Klasa V	Klasa VI	Klasa VII	Klasa VIII	Klasa IX	Shkolla
1	-	-	-	-	-	4	0	3	7	“Çajupi”
2	19	5	27	8	5	-	-	-	-	“Së bashku”

Sikurse shihet në klasat e larta ka një rënie të numrit të nxënësve romë. Kjo ndodh sepse ata me rritjen në moshë e braktisin shkollën për t’i ardhur në ndihmë familjeve të tyre. Megjithatë Drejtoria Arsimore ka ngritur një grup pune dhe ka caktuar inspektor të vaçantë që merret intesivisht me çështjen e frekuentimit dhe mbarëvajtjes së fëmijëve romë në shkollat e Gjirokastrës.

⁴⁷ Arkivi i Drejtorisë Arsimore të Rrethit Gjirokastrë, Informacion i Drejtorisë Rajonale Gjirokastrë për MAS, tetor 2015, fl. 2-3.